



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:190878

Datë: 09.10.2024

Numri i dokumentit: 06276949

C.nr.2692/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.O. me vendbanim në V, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Shëndetësisë (DSH në Vushtri), të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ardita Përçuku-Shyti, me objekt kontesti anulim konkursi, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 26.09.2024, ndërsa me datë 09.10.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.O..
- II. ANULOHET KONKURSI nr. 303/2024, i datës 25.03.2024, i shpallur nga e paditura DSH në Vushtri, për pozitën me titull “Doktor Specialist i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. S.I. në Vushtri”.
- III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses B.O. me të cilën ka kërkuar që të OBLIGOHET e paditura DSH në Vushtri, që ta rishpallë konkursin për pozitën e njëjtë si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi.
- IV. DETYROHET e paditura DSH në Vushtri, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 374.40 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 05.07.2024, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, me objekt kontesti anulim i konkursit nr. 303/2024, i shpallur nga e paditura DSH në Vushtri me datë 25.03.2024.

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes padisë, gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj në tërësi si e bazuar dhe të anulohet konkursi i të paditurës nr. 303/2024, i datës 25.03.2024, me arsyetimin se procesi rekrutues i këtij konkursi është bërë me shkelje të shumta të Udhëzimit Administrativ MFPT-së- 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Ka shtuar se konkursi nuk është shpallur konform nenit 7 par 1.1.11 sepse nuk është përcaktuar një kalendar të përafërt të procedurës të rekrutimit, se kandidatët janë udhëzuar që aplikacionet t'i dorëzojnë fizikisht në Qendrën për Shërbim Qytetar, kurse me nenin 8 të UA-së përcaktohet që aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike, se në konkurs është përcaktuar që kalueshmëria të jetë me një minimum prej 70 pikëve, kurse me nenin 13 par 1 të UA-së theksohet se minimumi i kalueshmërisë është 50 pikë, se nuk janë respektuar afatet e mbajtjes së testit me shkrim që sipas nenit 14 par 2 të UA-së theksohet se duhet të jetë brenda 10 ditësh pas verifikimit paraprak të kandidatëve, ndërsa në këtë konkurs njoftimi për verifikimin paraprak është bërë me datë 03.05.2024, kurse testi me shkrim është mbajtur me datë 17.05.2024, se rezultatet e testit me shkrim janë publikuar ditën e katërt (4) e jo brenda tre (3) ditëve siç përcaktohet me nenin 15 par 1 të UA-së, se intervista me gojë është mbajtur me datë 03.06.2024, edhe pse mbyllja e testit me shkrim kishte përfunduar me datë 21.05.2024, çka është në kundërshtim me nenin 18 par 2 të UA-së, se pas intervistës me gojë, komisioni vlerësues ka publikuar listën me emrat e kandidatëve me pikët totale për të gjitha fazat e konkursit e jo pikët e fituara nga kandidatët në mënyrë specifike, konkretisht se pikët e intervistës nuk janë publikuar asnjëherë e që është në kundërshtim me nenin 19 par 4, të UA-së dhe se e paditura nuk ka themeluar komisione vlerësuese dhe atë të ankesave si komisione të përkohshme që sipas nenit 24 par 1 të UA-së duhet të themelohen për secilin konkurs por se në këtë proces si komision vlerësues ka vepruar komisioni i përhershëm i themeluar për konkursin 1325/2023 e po ashtu edhe komisioni i ankesave ka qenë i themeluar një vit më herët.

Po ashtu ka shtuar se kandidatja e përzgjedhur M.M. ka afërsi të madhe me kryetaren e komisionit vlerësues E.M., e cila ka qenë në ceremoninë e diplomimit të kandidatës së përzgjedhur dhe se dallimi në mes paditëses dhe kandidatës fituese ka qenë vetëm 1.5 pikë në rezultatet përfundimtare pavarësisht se paditësja ka diplomuar gjashtë muaj para kandidatës fituese dhe se ka pasur më shumë trajnime sesa kandidatja e përzgjedhur dhe për këtë arsye nuk ka mundur që të dy CV-të e kandidatëve të vlerësohen me nga 10 pikë e po ashtu se njëra nga pyetjet e testit (25) për të gjithë kandidatët e ka pasur të hijezuar përgjigjen e saktë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 104 euro për padi dhe nga 135.20 euro për dy seanca, në shumën e përgjithshme prej 374.40 euro.

E paditura, me përgjigje në padi, gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, duke kërkuar që gjykata ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e saj. Ka theksuar se konkursi nr. 303/2024, i datës 25.03.2024 është zhvilluar konform afateve ligjore të përcaktuara me UA-në MFPT-së- 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik. Ka shtuar se pasi komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave me datë 13.05.2024 ka vendosur për ankesat lidhur me verifikimin paraprak të kandidatëve, kurse testi me shkrim është mbajtur me datë 17.05.2024, ndërsa rezultatet e testit janë shpallur me datë 21.05.2024 sepse ditët 18 dhe 19 maj 2024 kanë qenë gjatë fundjavës (shtunë dhe diele), kështu që dita e parë e punës ka qenë 21.05.2024, kur edhe janë publikuar rezultatet, kurse pasi ka pasur ankesa ndaj rezultateve të testit me shkrim, komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave ka vendosur për to me vendimin e datës 30.05.2024 dhe më pas është vazhduar me procedurën e intervistimit, prandaj e paditura duke u bazuar në nenin 10 par 2, ka theksuar se ankesa e kandidatëve i kanë pezulluar rrjedhën e procesit, rezulton se edhe afatet ligjore të procedurave të konkursit kanë qenë konform këtij UA. Ka shtuar po ashtu se është i pabazuar pretendimi i paditëses se kryetarja e komisionit vlerësues ka pasur afërsi me kandidaten fituese dhe fotografitë e ceremonisë së diplomimit të kandidatës fituese në rrjetin social “Facebook”, nuk dëshmojnë asgjë në këtë proces e po ashtu se fakti se kandidatja e përzgjedhur (M.M.) ka qenë më e mira në këtë proces rekrutues dëshmohet edhe në atë se ajo ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare të studimeve prej 9.02, ndërsa paditësja me 8.86, ndërsa trajnimet e kandidatëve sipas konkursit nuk kanë qenë si kushte thelbësore për tu vlerësuar. Ndërsa lidhur me pretendimin se njëra nga pyetjet ka qenë e hijezuar si e saktë, ka theksuar se edhe po të jetë e hijezuar, poentomi do të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova:

- Konkursi numër 303/2024, i datës 25.03.2024;
- Vendimi për themelimin e komisionit për përzgjedhjen kandidatëve nr. 1563/23, i datës 22.12.2023;
- Vendimi nr. 454/23 për themelimin e komisionit të ankesave i datës 19.04.2023;
- Vendimi 226/2024, i datës 07.03.2024 për ndryshimin e vendimit 454/2023 të datës 19.04.2023, për themelimin e komisionit të ankesave;
- Verifikimi paraprak i kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret i datës 03.05.2024;
- Njoftim i datës 14.05.2024, lidhur me mbajtjen e testit me shkrim për datën 17.05.2024;
- Njoftim lidhur me rezultatet e testit me shkrim i datës 21.05.2024;
- Njoftim lidhur me mbajtjen e intervistës i datës 30.05.2024;
- Njoftimet përmes mesazheve telefonike (screenshots) të paditëses dhe të paditurës nga numri i telefonit +38349221922, i dërguar nga menaxheri i personelit të QKMF L.H., me mundësinë për ta parë testin të datës 23.05.2024, 24.05.2024 dhe 31.05.2024;
- Fotografitë e bashkangjitura nga rrjeti social facebook së kandidatës M.M.;
- Vendimi i Komisionit të ankesave e lidhur me ankesën e Fitim Ademi, i datës 30.05.2024;
- Përmbledhja e testit me gojë e datës 03.06.2024;
- Dosja e kandidatës M.M. (përfshihet aplikacioni, CV, licenca dëshminë mbi kualifikimin, testi me shkrim, përvoja e punës si dhe trajnimet) ;
- Dosja e kandidatës B.O. (përfshihet aplikacioni, CV, licenca dëshminë mbi kualifikimin, testi me shkrim, përvoja e punës si dhe trajnimet);
- Raporti Pre Eliminuar me pikët e kandidatëve, i datës 04.06.2024;
- Raporti përfundimtar i kandidatëve i datës 11.06.2024;

- Dosja e ankesës së A.M. e datës 07.05.2024, e dorëzuar nga DSH në gjykatë më datë 19.09.2024 (përfshihet refuzimi i aplikacionit i datës 03.05.2024 dhe refuzimi i ankesës i datës 13.05.2024) dhe
- Dosja e ankesës së Fitim Ademi e datës 22.05.2024, e dorëzuar nga DSH në gjykatë më datë 19.09.2024 (përfshihet ankesa më datë 17.05.2024, e paraqitur te e paditura më datë 22.05.2024 dhe vendimi për refuzimin e ankesës i datës 30.05.2024)

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, përgjigjes në padi si dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, duke çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja i ishte nënshtruar procedurave rekrutuese në konkursin nr. 303/2024, i datës 25.03.2024 të shpallur nga e paditura, për pozitën “Doktor Specialist i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. S.I. në Vushtrri”, nuk ishte kontestuese po ashtu edhe fakti se ajo në këtë proces ishte renditur si e dyta. (Për këtë arsye gjykata nuk do të lëshohet as në elaborimin e provave/akteve që kanë të bëjnë me dosjen e provave të aplikacionit të paditëses).

Kontestuese në mes palëve ishte nëse procesi i konkursit kontestues ishte zhvilluar ashtu siç përcaktohet me dispozitat UA-së MFPT-së- 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik (Tani e tutje UA 01/2024) dhe mënyra e vlerësimit të kandidatës fituese për pozitën konkurruese.

Nga Konkursi numër 303/2024, i datës 25.03.2024 i shpallur nga e paditura me titull “Doktor Specialist i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. S.I. në Vushtrri”, është përcaktuar që konkursi është i shpallur duke u bazuar në nenet 80 dhe 81 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik si dhe UA 01/2024 dhe atë për një pozitë me kohë të pacaktuar. Sa i përket mënyrës së vlerësimit është theksuar se testi me shkrim ka një total prej 70 pikëve kurse kalueshmëria është 50 pikë, jetëshkrimi (CV) me 10 pikë dhe intervista me gojë 20 pikë, me një total prej 100 pikëve, kurse kalueshmëria është vlerësuar se është arritura e së paku 70 pikëve nga përmbledhja e të gjitha fazave të konkursit, kurse është përcaktuar që

aplikacionet për aplikim mund t'i marrin fizikisht në Qendrën për Shërbim me Qytetarë apo t'i shkarkojnë në web-faqja e gjykatës, ndërsa dorëzimi i aplikacioneve të plotësuara është caktuar që të bëhet vetëm në Qendrën për Shërbim me Qytetarë (fizikisht).

Nga vendimi për themelimin e komisionit për përzgjedhjen kandidatëve nr. 1563/23, i datës 22.12.2023, është vërtetuar se Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, ka themeluar komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin nr. 1325/23, të datës 15.11.2023 për vendin e punës “Doktor specialist i mjekësisë familjare ose Doktor i Mjekësisë-Mjek i Përgjithshëm, në QKMF “Dr. S.I.”, në Vushtri dhe ky komision ka qenë i përbërë nga Dr. Specialist E.M., kryesuese e komisionit, kurse anëtarët e tjerë kanë qenë Dr. B.S., Dr. Specialist Z.K., F.K.-Shef financave në QKMF dhe L.H., nga zyra e personelit në QKMF.

Nga Vendimi nr. 454/23 për themelimin e komisionit të ankesave i datës 19.04.2023, është vërtetuar se Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, ka themeluar komisionin e ankesave për shqyrtimin e ankesave në shëndetësi në Komunën e Vushtrrisë, me përbërje prej N.F., kryesues i komisionit dhe anëtarët F.H - Z. dhe B.K.. Sipas këtij vendimi, ky komision ka pasur përgjegjësi t'i trajtoj të gjitha ankesat që paraqiten në kuadër të shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë, me mandat prej tre (3) vitesh.

Nga Vendimi 226/2024, i datës 07.03.2024 për ndryshimin e vendimit 454/2023 të datës 19.04.2023, për themelimin e komisionit të ankesave, është vërtetuar se Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, ka bërë ndryshimin e vendimit të datës 19.04.2024 për themelimin e komisionit të ankesave, ashtu që ka ndryshuar njërin nga anëtarët e komisionit, konkretisht me këtë vendim, anëtarja e komisionit F.H - Z., është zëvendësuar me M.H..

Nga provat: Verifikimi paraprak i kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret i datës 03.05.2024, Njoftim i datës 14.05.2024, lidhur me mbajtjen e testit me shkrim për datën 17.05.2024, Njoftim lidhur me rezultatet e testit me shkrim i datës 21.05.2024, Njoftim i datës 30.05.2024 lidhur me mbajtjen e intervistës me datë 03.06.2024, Raporti nr. 26630/24 Pre Eliminuar me pikët e kandidatëve, i datës 04.06.2024, Raporti përfundimtar i kandidatëve nr.27811/24, i datës 11.06.2024, Vendimi nr. 12569/24, i datës 13.05.2024 për refuzimin e ankesës së kandidatit A.M. dhe Vendimi nr. 25649/24, i datës 30.05.2024 për refuzimin e ankesës së kandidatit Fitim Ademi, gjykata ka vërtetuar se në procedurën e rekrutimit të konkursit kontestues, e paditura ka

proceduar hapat e konkursit duke u referuar në Udhëzimin Administrativ MFPT-së- 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Nga Raporti nr. 26630/24 Pre Eliminuar me pikët e kandidatëve, i datës 04.06.2024, është vërtetuar se anëtarë të komisionit vlerësues për konkursin kontestues (nr. 303/2024) kanë qenë Dr. Specialist E.M., Dr. Specialist Z.K., Dr. B.S., F.K. dhe L.H., i cili komision kandidaten M.M. e kishte vlerësuar me pikë totale në të gjitha fazat e konkursit prej 98.5 pikëve, kurse kandidaten B.O. (paditësja) me 97 pikë.

Nga Vendimi nr. 12569/24, i datës 13.05.2024 për refuzimin e ankesës së kandidatit A.M. dhe Vendimi nr. 25649/24, i datës 30.05.2024 për refuzimin e ankesës së kandidatit Fitim Ademi, gjykata ka vërtetuar se anëtarë të komisionit të ankesave për konkursin kontestues (nr. 303/2024) kanë qenë N.F., M.H. dhe B.K..

Nga Raporti përfundimtar i kandidatëve nr. 27811, i datës 11.06.2024, është vërtetuar se komisioni vlerësues ka zgjedhur si kandidatë fituese M.M.

Pjesa aprovuese e kërkesëpadisë

Me nenin 5.1 të [Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik](#), është përcaktuar që “*Kategoritë e zyrtarëve/publik janë: 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik*”, kurse sipas par 3, të këtij neni parashihet që “*Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës*”. Po ashtu me nenin 77 par 1 të këtij ligji theksohet se “*Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës*”.

Pasi sipas Ligjit për Zyrtarët Publik është përcaktuar që zyrtari i shërbimit publik nga fusha e shëndetësisë konsiderohet si nëpunës publik dhe për të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, gjykata konstaton se edhe në çështjen kontestuese është dashur që gjatë gjithë procesit rekrutues të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj. Me nenin

8 par 1, të [Ligjit nr.03/L-212 të Punës](#), përcaktohet që *“Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës, kurse me paragrafin 2 të tij thuhet se “Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”.*

Përderisa konkursi kontestues është shpallur me datë 25.03.2024, i njëjti është dashur të zhvillohet në harmoni me dispozitat e [UA-së MFPT-së- 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik](#). Mirëpo edhe pse në preambulën e këtij konkursi të shpallur dhe akteve të tjera në procedimin e këtij konkursi (Njoftimeve, vendimeve, raportit pre eliminuar, raportit përfundimtar) e paditura ka theksuar se konkursi shpallet dhe zhvillohet në bazë të UA-së, gjykata pas analizimit të të gjitha provave të shqyrtimit kryesor, ka arritur në përfundim se pavarësisht se sipas nenit 2.1 të tij ka përcaktuar që *“Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për të gjitha institucionet publike”*, ka rezultuar se e paditura nuk ka vepruar sipas kritereve të këtij UA-je dhe atë për arsyt si më poshtë.

Me nenin 24 par 1 të UA-së 01/2024, përcaktohet që *“Me qëllim të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistave të kandidatëve të konkursit publik, institucioni publik themelon Komisionin Vlerësues që është si trupe e përkohshme, i përbërë nga pesë (5) anëtar”*, me paragrafin 2 të tij është theksuar se *“Në përbërje të Komisionit Vlerësues duhet të marrin pjesë eprori/mbikëqyrësi i pozitës që është në konkurs publik, dy përfaqësues tjerë të njësisë ku është shpall konkursi publik, një përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore dhe një përfaqësues nga njësitë tjera, sipas vendimit të institucionit të publik”*, kurse me paragrafin 3, të këtij neni janë përcaktuar kompetencat e këtij komisioni, të cilat janë: të përzgjedh dhe cakton pyetjet dhe esenë e testimit me shkrim, të vlerëson testimin me shkrim të kandidatëve, të interviston dhe vlerëson kandidatët gjatë fazës së intervistave dhe të harton raport të punës pas çdo faze të konkursit publik.

Gjykata, lidhur me konkursin kontestues, nga provat e lëshuara nga e paditura, konkretisht nga Raporti nr. 26630/24 Pre Eliminuar me pikët e kandidatëve, i datës 04.06.2024 dhe nga çelësi i pyetjeve të testit me shkrim të datës 17.05.2024, ka vërtetuar se anëtarë të Komisionit vlerësues të komisionit rekrutes të konkursit i cili është objekt i këtij kontesti kanë qenë Dr. Specialist E.M., Dr. Specialist Z.K., Dr. B.S., F.K. dhe L.H., i cili komision nuk është krijuar si trupë e përkohshme për konkursin kontestues ashtu siç përcaktohet me nenin 24 par 1 të UA-së 01/2024, por që ky komision vlerësues ka vepruar sipas vendimit për themelimin e komisionit për

përzgjedhjen kandidatëve me nr. 1563/23, i datës 22.12.2023, me të cilin vendim Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, ka themeluar komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin e shpallur nga e paditura me nr. 1325/23, të datës 15.11.2023.

Pra e paditura, për konkursin kontestues nuk ka themeluar komision të veçantë vlerësues për konkursin e shpallur, por në këtë konkurs ka vepruar komisioni vlerësues i caktuar për një konkurs tjetër (nr. 1325/23, të datës 15.11.2023) dhe se ky komision është themeluar akoma pa hyrë në fuqi UA-së 01/2024, e po ashtu duhet theksuar se ky fakt nuk është kontestuar as nga ana e palës së paditur në këtë procedurë gjyqësore.

Në anën tjetër përpos komisionit vlerësues me nenin 25 par 1 të UA-së 01/2024, përcaktohet që *“Me qëllim të funksionimit si instancë e ankesave për procesin e konkursit publik, **për çdo konkurs publik** institucioni publik themelon Komisionin e Ankesave që është trup e përkohshëm, i përbërë nga tre (3) anëtarë”*, ndërsa me paragrafin 2, të këtij neni parashihet që *“Në përbërjen e Komisionit të Ankesave duhet marrin pjesë një jurist nga njësia përkatëse ligjore, një zyrtar nga njësia e burimeve njerëzore dhe një zyrtar përkatës i fushës për të cilin është shpallur procedura e konkursit publik”*.

Për këtë kërkesë ligjore, gjykata, lidhur me konkursin që është objekt i çështjes, nga provat e lëshuara nga e paditura, konkretisht nga Vendimi nr. 12569/24, i datës 13.05.2024 për refuzimin e ankesës së kandidatit A.M. dhe Vendimi nr. 25649/24, i datës 30.05.2024 për refuzimin e ankesës së kandidatit Fitim Ademi, ka vërtetuar se anëtarë të komisionit të ankesave për konkursin kontestues kanë qenë N.F., M.H. dhe B.K., mirëpo ky komision nuk është themeluar si trupë e përkohshme për konkursin kontestues ashtu siç përcaktohet me nenin 25 par 1 të UA-së 01/2024, por që ky komision i ankesave ka qenë i themeluar me Vendimin nr. 454/2023 të datës 19.04.2023 dhe ndryshimin e këtij vendimi me nr. 226/2024, i datës 07.03.2024. Pra rezulton se edhe komisioni i ankesave prej tre anëtarësh që ka vepruar në konkursin kontestues është themeluar (19.04.2023) dhe ndryshuar (07.03.2024) akoma pa hyrë në fuqi UA-së 01/2024 (17.03.2024), e po ashtu duhet theksuar se ky fakt nuk është kontestuar as nga ana e palës së paditur në këtë procedurë gjyqësore.

Me nenin 7 par 1.10 të UA-së 01/2024 (Përmbajtja e Konkursit), përcaktohet që konkursi publik duhet të përmbaj informatat e domosdoshme, ndër të tjera edhe mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e poentimit të procesit rekrutes, ashtu që me nenin 13 par 1 të këtij UA-je, është paraparë që *“Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria*

është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik”, kurse me paragrafin 3 të këtij neni thuhet se “Për pozitat të cilat kërkohet testimi me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervistimi deri në njëzetë (20) pikë”, mirëpo nga [Konkursi numër 303/2024, i datës 25.03.2024](#), i shpallur nga e paditura, është vërtetuar se te “mënyra e vlerësimit”, është përcaktuar se testimi me shkrim vlerësohet me 70 pikë, me kalueshmëri prej 50 pikësh, Jetëshkrimi (CV) me 10 pikë dhe intervista me 10 pikë, ndërsa kalueshmëria përfundimtare është arritja e së paku 70 pikëve nga përmbledhja e të gjitha fazave të konkursit. Nga kjo rezulton se e paditura me këtë konkurs pavarësisht se mënyrën e vlerësimit veç e veç e ka pasur të harmonizuar me dispozitatat e lartcekura të UA-së, lidhur me minimumin e kalueshmërisë të pikëve totale ka përcaktuar që duhet arritur pikë me të larta (70 pikë) sesa që përcaktohen me nenin 13 par 1 të UA-së (55 pikë).

Po ashtu është i bazuar pretendimi i paditëses se pavarësisht se me nenin 8 par 1 të UA-së 01/2024 (Mënyra e aplikimit), përcaktohet që “Aplikimi për konkurset e shpallura nga institucioni publik bëhet vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet platformave elektronike përkatëse apo adresave elektronike”, në konkursin kontestues të shpallur nga e paditura, nga kandidatët e konkursit është kërkuar që aplikimin ta dorëzojnë vetëm në Qendrën për Shërbim me Qytetarë.

Përfundimisht gjykata, nga vlerësimi i dispozitave që rregullojnë procedurën e rekrutimit të konkurseve publike dhe nga provat e lartcekura të administruara në shqyrtimin kryesor, të cilat janë lëshuar nga e paditura, është arritur të vërtetohet se e paditura nuk ka vepruar sipas rrugallave të përcaktuara me UA-në 01/2024, e të cilat janë të detyrueshme të zbatohen nga secili institucion publik që shpallë konkurse për pozita publike, siç është rasti i pozitës së konkursit që është objekt i kësaj çështje.

Pra gjykata e ka vërtetuar se e paditura nuk ka themeluar komisione të veçanta vlerësues e as komision të ankesave për këtë konkurs, të cilat komisione duhet të jenë si trupa të përkohshme vetëm për konkursin që shpallet dhe në këtë mënyrë do të sigurohej një proces i rregullt rekrutues, duke garantuar llogaridhënie të institucionit publik, ashtu siç përcaktohet me nenin 8 Të Ligjit të Punës dhe nenin 4 të UA-së 01/2024, kurse forma se si ka vepruar e paditura, duke e zhvilluar procesin rekrutes me një komisioni vlerësues të themeluar për një konkurs tjetër të vitit të kaluar dhe me një komision të përgjithshëm të ankesave për të gjitha ankesat në shëndetësi, paraqesin kundërligjshmëri në procesin rekrutes të konkursit të cilin paditësja ka

paraqitur kërkesëpadi që të anulohet. E përpos tyre, ashtu siç është thekuar më lartë gjykata ka vërtetuar se në konkursin e shpallur janë dhënë informacione të gabuara për kandidatët lidhur me mënyrën e vlerësimit dhe mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve e jo ashtu siç e përcakton UA-ja 01/2024.

Gjykata përpos provave dhe pretendimeve të sqaruara më lartë, ka vlerësuar edhe provat e tjera të administruara dhe pretendimet e paditëses lidhur me mos respektimin e afateve kohore për mbajtjen e fazave rekrutuese dhe të trajtimit e ankesave të kandidatëve e po ashtu edhe pretendimet lidhur me konfliktin të interesit të kryetares së komisionit vlerësues dhe parregullsitë në mënyrën e vlerësimit, mirëpo për të njëjtat nuk do të analizohen në detaje për arsye se arsyetimi i lartcekur është i mjaftueshëm për gjykatën që të vendos si në dispozitivin I, me të cilin e ka anuluar konkursin rekrutues.

Në anën tjetër pretendimi i të paditurës i dhënë në përgjigje në padi dhe gjatë seancave se procesi rekrutes është zhvilluar në harmoni me procedurat e UA-së 01/2024, është tërësisht i pabazuar sepse ashtu siç është sqaruar më lartë, e paditura nuk ka zbatuar detyrimet thelbësore të institucioneve publike që bëjnë shpalljen e konkurseve për pozita publike siç është themelimi i komisionit vlerësues dhe të ankesave, çka ka ndikuar që për gjykatën i tërë procesi rekrutes të konsiderohet si i jashtëligjshëm dhe i njëjti të anulohet.

Lidhur me pjesën refuzuese

Gjykata me dispozitivin II, të këtij aktgjykimi ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për pjesën me të cilën ajo ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që ta rishpallë konkursin kontestues për pozitën e njëjtë, ngase kjo kërkesëpadi është e pabazuar për faktin se për mundësinë e shpalljes së konkurseve publike, me nenin 17 par 1, të Ligjit nr. 08/1-197 për Zyrarët Publik, që aktualisht është në fuqi, është përcaktuar që çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik, përgatit planin vjetor të personelit në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni ka paraparë që plani vjetor i personelit përmban nevojat për personel kompetent dhe cilësor në arritjen e misionit dhe objektivave të institucionit, prandaj gjykata nuk mundet që ta detyroj të paditurën që ta rishpallë konkursin për pozitën me titull “*Doktor Specialist i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. S.I. në Vushtrri*” sepse shpallja e këtij të vendi të punës mund të bëhet varësisht nga nevojat dhe mundësitë buxhetore të së paditurës pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së, sipas të cilit përcaktohet që *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, ashtu që pala e paditur detyrohet që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë 104 euro për padi dhe nga 135.20 euro për dy seanca, në shumën e përgjithshme prej 374.40 euro .

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:190878, C.nr.2692/2024, me datë 09.10.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimimit të njëjtë, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.